

# FIF - PPK Rajonale për NVM - Banka per Biznes II

**Shteti:** KOSOVË

**Numri i Projektit:** 51813

**Sektori i aktivitetit:** Kredi depozituese (banka)

**Lloji i njoftimit:** PRIVAT

**Kategoria mjedisore:** IF

**Datat e aprovimit:** 26 tetor 2021

**Statusi:** Në hulumtim, në pritje të shqyrtimit përfundimtar

**Data e shpalosjes së PPD-së në gjuhën angleze:** 26 tetor 2021

## Përshkrimi i Projektit

Kredi seniore e pasiguar deri në 5.0 milionë EUR në një shumë (transh) të vetme për Bankën për Biznes ("BpB"), në kuadër të Programit Rajonal për Përkrahje të Konkurrueshmërisë (PPK) së NVM-ve (PPK për NVM).

## Objektivat e Projektit

Projekti do të përkrahë investimet në NVM për të avancuar kapacitetet prodhuese dhe përputhjen me Direktivat të BE-së në fushën e mbrojtjes së mjedisit, sigurisë së punëtorëve dhe produkteve, si dhe cilësisë së produktit. Investimet do të përzgjidhen në bazë të kriterëve të kualifikimit teknik dhe financiar, të parapara me Deklaratën e Politikave për PPK-në Rajonal për NVM-të. Përkrahja për NVM-të është përshtatur si kombinim i qasjes në financa, me asistencë TC dhe jo-TC. Së paku 60% e të ardhurave të përdorura do të orientohen kah financimi i investimeve që kualifikohen për GET, në pajtim me Deklaratën e Politikave.

## Ndikimi në tranzicion

ETI 60

Projekti kontribuon në objektivat e PPK-së për NVM, në përkrahje të

**cilësisë konkurruese dhe rezistente të TI-së.**

**Konkurrueshmëria:** Programi do të inkurajojë konkurrueshmërinë e NVM-ve në Ballkanin Perëndimor, duke (i) mbështetur NVM-të për qasje në financim, drejt investimeve për plotësim të standardeve të BE-së; si dhe (ii) ndihma për NVM-të për të siguruar qasje në këshilla dhe njohuri për realizim dhe zbatim të standardeve të BE-së, si dhe për t'u bërë konkurruese.

**Rezistenca:** Projekti do të nxisë rezistencën e NVM-ve, pasi që nën-kreditorët priten të jenë komercialisht të pranueshëm, që duhet të arrihet duke pasur parasysh ekspertizën në lëshimin e kredive, si dhe cilësinë e duhur të portofolit të BpB-së.

## Informatat për Klientin

BANKA PËR BIZNES SHA

Banka per Biznes, Sh.A., është bankë e nivelit 2 në Kosovë, që ofron një gamë të gjerë të produkteve komerciale bankare për të gjitha segmentet e klientëve, me fokus kryesor tek mikro-ndërmarrjet, NVM-të dhe tregtia. BpB-ja, e themeluar në vitin 2001, është banka e 7-të me madhësi në Kosovë midis 11 bankave që operojnë në treg, me hise tregu prej 6.5% me asete totale, si dhe 6.4% me neto-kredi, në periudhën 1H 2021. BERZH-i është bërë aksionar në BpB në vitin 2010, me blerjen e 10.0% të aksioneve, ku pjesa tjetër e aksioneve janë në pronësi të biznesmenëve kosovarë (77.6%), Moneta Sh.p.k. (7.8%) si dhe Banka di Cividale (4.6%).

## **Përmbledhja e Financimit nga BERZH**

5,000,000.00 Euro

## **Kostoja totale e Projektit**

5,000,000.00 Euro

## **Përmbledhje mjedisore dhe sociale**

IF i kategorizuar (2019 ESP). BpB është klient ekzistuese dhe i ka ofruar BERZH Raporte Vjetore të kënaqshme për MeS deri më sot. BpB-ja do të obligohet të vazhdojë të implementojë procedurën e menaxhimit të rreziqeve mjedisore e sociale për kredi për mikro-ndërmarrje, NVM dhe korporata; të vazhdojë zbatimin e Kritereve të Performancës (PR) 2, 4 dhe 9 të BERZH-it, duke përfshirë respektimin e Listës së zgjeruar të përjashtimeve për MeS, si dhe Listës Referente, të vendosur me ESP 2019, si dhe të dorëzojë Raporte Vjetore për MeS tek BERZH.

## **Bashkëpunimi teknik**

**TC:** Bashkëpunimi teknik (TC) do të përfshijë përkrahjen nga Konsulentët e Programit PKK për NVM-të, e cila përfshin një Konsulent Projekti, që ndihmon në implementimin, marketingun dhe monitorimin e Programit, si dhe një Konsulent tjetër Verifikues që bën verifikimin e implementimit teknik të investimeve nga Nën-kreditorët përpara se të lirohet pagesa stimuluese.

**Jo-TC:** 0.75 milionë euro për grante për nën-kreditorët për zbatimin e investimeve të kualifikuara, në pajtim me Deklaratën e Politikave për PPK të NVM-ve.

Granti bashkë-investues dhe burimet e TC-së sigurohen nga Bashkimi Evropian.

## **Shtueshmëria**

Shtueshmëria arrihet duke kombinuar financimin e domosdoshëm afatmesëm me TC-në dhe grantet në një pako që ndihmon në çlirimin e potencialit të plotë të NVM-ve në Kosovë, si dhe është e strukturuar për të promovuar pajtueshmërinë me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, duke përmirësuar ofertën e financimit të dedikuar dhe duke rritur kërkesën për investime të tilla.

## **Informata kontaktimi të Kompanisë:**

Adonis Bllacaku

[adonis.bllacaku@bpbbank.com](mailto:adonis.bllacaku@bpbbank.com)

+383 49 904 804

[www.bpbbank.com](http://www.bpbbank.com)

Rr. Ukshin Hoti, Nr. 128, Prishtinë 10000, Kosovë

## Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

## Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

## Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

## Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

## Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efektive për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime për praktikën mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek [compliance@ebrd.com](mailto:compliance@ebrd.com). Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

## Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpall informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

## Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në nivelin e Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale

dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit [ipam@ebrd.com](mailto:ipam@ebrd.com) për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.